



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**  
**Nr. 43, datë 13.06.2018**

**PËR**  
**MARRJEN E MASËS ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË UJËSJELLËS**  
**KANALIZIME TROPOJË SH.A.**

Në mbështetje të gërmës "h", të pikës 1 të nenit 14, nenit 15 dhe nenit 32/1 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe Rregullores së Inspektimit të miratuar me vendim të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 58, datë 29.12.2017, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**VENDOSI:**

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tropojë sh.a. dënohet me gjobë në shumën 100 000 lekë për moszbatimin e vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator Nr. 29, datë 13.10.2004 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik të sh.a ujësjiellës Tropojë"
2. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Tropojë sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet pranë Gjykatës Administrative Tiranë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni mbi vendimin.

**K R Y E T A R I**

**Ndriçim SHANI**